



## EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

**i mbledhjes së katërt të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 23.5.2024, duke filluar në orën 10:00.**

**Në mbledhje morën pjesë:** Fehmi Kupina - kryesues i komitetit, anëtarët e komitetit: Milazim Vitija, Jeta Rafuna,, Leutrim Retkoceri, Shegë Beqiri, Arbnora Berisha, Gëzim Sveçla, Nora Kelmendi, Mirsad Vitia dhe Bahri Gashi .

**Në mbledhje ishin të pranishëm edhe:** Përparim Rama- Kryetar i Kryeqytetit, Shkëmb Manaj - këshilltar për çështje ligjore, Osman Bllaca, Florim Krasniqi - përfaqësues i Drejtorisë së Urbanizmit, Arbër Sadiku – drejtori Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Mjedisor, Arben Kqira- udhëheqës i Zyrës ligjore.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Fehmi Kupina, kryesues i komitetit, me këtë:

### REND DITE

- 1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit i mbledhjes së tretë të Komitetit për Politikë dhe Financa;**
- 2. Propozim-vendimi për vënien në konsultim publik për Projektrregulloren për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Prishtinës;**
- 3. Diskutim lidhur me aktivitetin e prokurimit: Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues: 119 programi për ofrimin e shërbimeve të energjisë në ulje të shpenzimeve financiare në Komunën e Prishtinës (SIPA UA 06.2021);**
- 4. Propozim-vendimi për subvencionimin e Elza Ujkanit;**
- 5. Informatë lidhur me punën e komisionit të aksionarëve të Ndërmarrjes publike “Prishtina Parking”, SHA;**
- 6. Të ndryshme.**

Para se të fillonin me diskutimet për pikat e rendit të ditës, asamblisti **Gëzim Sveçla** pyeti se në planin e punës a ka qenë edhe raportimi për Ndërmarrjen “Pastrimi”.

**Kryesuesi:** - tha se emailin ia kemi dërguar kryesuesit të aksionarëve dhe nuk më është përgjigjur.

**Arbër Sadiku:** - propozoi të përfshihen edhe dy pika të rendit të ditë. E para ka të bëjë me aprovimin e Planit të rregullues të hollësishëm “Kalabria” dhe e dyta: Vendimi për vënien në diskutim publik të Planit zhvillimor komunal të kryeqytetit, faleminderit.

**Gëzim Sveçla:** - pyeti drejtorin se sa ka material për Planin e Kalabrisë.

**Arbër Sadiku:** - tha se materiali është pjesa e hartografisë edhe pjesa tekstuale. Pjesë e hartografisë janë 11 harta edhe pjesa tekstuale.

**Gëzim Sveçla:** - pyeti drejtorin sa është sipërfaqja e përgjithshme (sa metra katror).

**Arbër Sadiku:** - tha se është 355.

**Gëzim Sveçla:** - pyeti drejtorin se këto 355 mijë metra katror a mund të kontrollohen për 24 orë?

**Arbër Sadiku:** - tha se nuk janë 24 orë, sepse ka pasur diskutim publik dhe shumica e vërejtjeve, të cilat kanë qenë prej banorëve shumë të njojur dhe shumicës prej jush.

**Gëzim Sveçla:** - d.m.th që nuk ka ndryshuar?

**Arbër Sadiku:** - tha se nuk ka ndryshime, por nuk ka qenë kërkesë nga fillimi, në parim çka kemi bërë jemi nis nga plani ekzistues kemi diskutuar disa herë, i kemi shikuar rrugët ku ka pasur probleme me rrugët në kuptimin teknik të realizimit edhe është përfill kërkesa e tyre për koeficientin e cila ka qenë gjithmonë shumë e njojur prej 1.8 me u kthy 2.4, kurse e vërtetë gjë që duhet të shtohet si risi është pjesa e tokës komunale me koeficientin që të ketë mundësi shtesë të ndërtimit në mënyrë që komuna ta ketë mundësinë me i realizuar disa investime publike mbi pronën e vet.

**Leutrim Retkoceri:** - pyeti sa është ai koeficient?

**Arbër Sadiku:** - tha se koeficienti është 7, koeficienti maksimal që lejohet me udhëzimin administrativ.

**Gëzim Sveçla:** - dha vërejtje pse materiali nuk është dorëzuar me kohë, ose të thirret seancë e jashtëzakonshme lidhur me Kalabrinë.

**Kryetari:** tha se para dy javë ne kemi qenë të gatshëm ta dorëzojmë materialin dhe është larguar nga rendi i ditës edhe jemi marrë vesh me kryesuesin, dokumentacioni është i gatshëm, diskutimet publike kanë ndodhur, kurse të gjithë e dimë se për çka po bëhet fjalë.

**Gëzim Sveçla:** - kritikoi kryetarin për premtimet që u ka bërë banorëve të Kalabrisë dhe po ashtu kritika në drejtim të vonesës së materialit, kur dihet se është një material voluminoz.

**Kryesuesi:** - shprehu pakënaqësi lidhur me shtyrjen e datave për mbledhjen e KPF-së dhe dakordimet që i kishte me kryetarin e të cilat nuk u respektuan, si dhe materiali i Kalabrisë dërgohet me vonesë pas orës 16. Tutje kërkoi seriozitet dhe kërkoi të sqarohet se nga kush duhet të pranohen emailet, nga z.Manaj apo nga Kryetari.

**Arben Kqira:** - tha se unë e kam marrë prej zyrës së kryetarit për ta dërguar thirrjen, por nuk e kam pas materialin, kur nuk e kam pas materialin kam menduar se e sjellin vetë në KPF, me vet faktin kur po më kërkojnë ta bëjë propozimin.

**Nora Kelmedi:** - tha se i keni dy përfaqësues ligjor dhe pa dashur të merret me emaile kërkoi përgjigje nga përfaqësuesit ligjor, nëse sot po e fusim këtë pikë të rendit të ditës pér nesë, a e thyejmë ligjin në bazë të legjisacionit.

**Arben Kqira:** - tha se në bazë të ligjit në fuqi rendin e ditës e bënë kryesuesi në marrëveshje me kryetarin, kryesuesi pa marrëveshje me kryetarin, në thyerje të ligjit e ka larguar prej rendit të ditës pikën, e PZHK-së, që ka pasur mundësi ta bërrë asambleja me votë me largu, duke shtuar se nuk është sjellë materiali 7 ditë siç e thotë ligji dhe kjo pikë largohet, por jo kryesuesi në një mënyrë arbitrale sepse është shkelje e ligjit.

**Shkëmb Manaj:** - tha se legjisacioni edhe rregullorja e Kuvendit e përcakton tri forma të përcaktimit të rendit të ditës në Kuvend. Kryesuesi me ligj është i obliguar në konsultim me kryetarin, me i dërguar pikat e rendit të ditës pér seancë, në momentin kur bëhet thirrja e seancës, kjo është e para, e dyta, pikat e rendit të ditës mund të përcaktohen në mbledhjen e Komitetit pér Politikë dhe Financa që jemi sot këtu, pikat minden me u propozua në KPF, është ne kompetencë të KPF. Në rastin e tretë përcaktohen drejtpërdrejtë në seancë të Kuvendit dhe zhvillimet në seanca vendosin të kalojë apo jo.

**Arbër Sadiku:** tha se linku ka qenë i skaduar, ai material është bërë gati më herët dhe nuk është hapur.

**Gëzim Sveçla:** - dha kritika në drejtim të materialit që determinon zhvillimin e kryeqytetit dhe ka qasje vetëm 7 ditë, në ç'rast tha se keni mundur ta dërgoni në kopje fizike, CD ose USB.

**Leutrim Retkoceri:** - shprehu shqetësimin lidhur me dërgimin e materialit në një link të paqasshëm pas 7 dite duke shtuar se pér këtë dikush duhet të japë llogari sepse është dokumenti më i rëndësishëm i komunës. Tutje tha se këtu po flasim pér planin urban të hollësishëm pér lagjen Kalabria, unë sa e kam parë këtë material këtu më ka lënë të kuptoj se kemi marrë propozim pér plan zhvillimor komunal, derisa zotimet dhe premtimet kanë qenë të futet plani rregullues Kalabria. Mandej tha se ne jemi duke folur pér propozimin e disa pikave të rendit të ditës dhe përpëra nuk kemi asnjë material, kurse pér Planin Kalabria ne tash e kuptuam që do të vijë me koeficient 7, ndërkaq ky plan është anuluar nga ministria pér shkak vërejtjes që e keni pasur, në rritje të koeficientit në 2.4 që ka qenë i paimplementueshëm ai plan, kurse sot unë po e dëgjoj planin se ka me ardhur koeficienti 7. Si ka mundësi me qenë shumë 2.4, ndërsa tani është koeficienti 7. Ai pyeti se pér kënd është ai koeficient 7, kujt i dedikohet ai koeficient 7, a është bë ky plan pér t'ju bë zgjidhje banorëve apo pér të ndryshuar koeficientin 7. Pastaj pyeti a do të vijë një plan pér t'ju bërrë një zgjidhje qytetarëve, pér t'u respektuar interesit publik, a do të ketë më shumë kopshte, më shumë parqe, më shumë qendra të mjekësisë familjare, etj. Në fund tha se si qytetar dua të di se çfarë do të ndodh, sepse do të jetojmë këtu dhe qytetarët presin minimalisht korrektësi dhe sinqeritet.

**Kryetari:** - tha, sa i përket se çka iu është premtuar qytetarëve të Kalabrisë, një plan rregullativ, shumë më i mirë nga ai që ju e keni votuar në qeverisjen e kaluar, ku e keni ngritur koeficientin nga 1.8 në 2.4 shabllon. Kemi kaluar në fazë të ndryshme të diskutimit publik edhe me qytetarët, kemi pasur takime në lagjen Kalabria, kemi pasur takime të shumta me qytetarin për të analizuar komplet zonën, për të kuptuar mirë se çfarë i duhet dhe si mundemi ne me e përballuar këtë ngritje 1.8 në 2.4, këtë problem që e keni krijuar në qeverisjen e kaluar, nuk i duhet Prishtinës 1.8 me 2.4, tash ju tregojë një plan rregullativ i cili ka qenë i pazbatueshmë si i tillë ku e keni ngritur prej 1.8 në 2.4, e kam treguar edhe koeficientin 7, tek stacioni i autobusëve, e kemi bërë edhe për qeverinë çdo pronë e cila është e qeverisë dhe e komunës, kemi kërkuar me ngrit koeficientin për arsyet e shpronësimit që kemi me bërë për unazën e kryeqytetit për Fshatin Olimpik sepse na duhet, kemi menduar mos me dhënë toka, por me iu dhënë mundësi të ndërtimit. Mirëpo kur e kam kuptuar se në toka të qeverisë ka edhe toka të AKP-së, ku mundet me pas dikush ndonjë kontratë, i kemi evituar të gjitha dhe e kemi lënë vetëm tek stacioni i autobusëve, ku e dimë se është e komunës edhe për këtë arsyet është koeficienti 7, në mënyrë që mos të japim toka, por me i shfrytëzuar mundësitet e koeficientit për me ndërtuar në relacion me privatin, ndërsa e kemi ngritur dhe e kemi kalkuluar ku mundemi me zhvilluar edhe unazën e kryeqytetit, me zhvilluar edhe Fshatin Olimpik d.m.th. të gjitha këto pa një ngarkesë në buxhet të shtetit, kjo është ideja e koeficientit 7.

**Leutrim Retkoceri:** - dha kritika në drejtim të kryetarit lidhur me betonimin dhe bllokimin e lagjeve që do t'i bëhet dhe mosmbajtjen e premtimit sa i përket koeficienteve karshi banorëve.

**Bahri Gashi:** - kerkoi nga drejtori, nëse ka mundësi që krejt Prishtinën që e keni bërë në bazë të kérkesave dhe ankesave të banorëve të bëhet me një tik, kurdo që sillet ai material sepse ne nuk e dimë se çfarë keni ndryshuar ju. Mandej tha se kam dëgjuar për "Rrugën A" se ia keni fal koeficientin, a keni mundësi ju me na njoftuar neve se jo banorët me na njoftuar drejt, por ju me na njoftuar ky ka qenë 1.8 dhe është bërë 2.4 dhe ky ka qenë 2.4 dhe është bërë 7 dhe arsyet pse janë bërë këto. Në fund kerkoi që ndryshimet të na vijnë në letër dhe të thirret seancë.

**Gëzim Sveçla:** tha se mund të presim disa ditë, por materiali të jetë i gatshëm, pasi mund të thirret edhe seancë e jashtëzakonshme dhe ne do t'i përgjigjemi thirrjes.

**Kryetari:** tha se plani është i gatshëm dhe qëndroj pas asaj që me e fut në rend të ditës.

**Kryesuesi:** - tha se nuk ka material dhe kryetari po propozon, kush është për propozimin e drejtorit Arbër Sadiku, me e fut në rend të ditës, aprovin e Planit të hollësishëm të Kalabrisë, kush është për, **2 vota për, 7 janë kundër, 1 abstenim.**

Po ashtu pika e dytë e propozuar nga Arbër Sadiku, është Propozim- vendimi për vënienë në diskutim publik të PZHK-së, kush është për këtë pikë me e fut në rend të ditës, **2 vota për, 7 janë kundër, 1 abstenim.**

#### **Pika e parë**

**Miratimi i ekstraktit të procesverbalit i mbledhjes së tretë të Komitetit për Politikë dhe Financa.**

**Gëzim Sveçla** kerkoi të ndërrohet termi konstatoj dhe të zëvendësohet me termin u përkrahen për pikat të cilat shkojnë tutje për Kuvend.

**Kryesuesi** tha se u përkrah **Ekstrakti i procesverbalit i mbledhjes së tretë të Komitetit për Politikë e Financa** me vërejtjen nga asamblisti Gëzim Sveçla.

**Pika e dytë**

**Propozim-vendimi** për vënien në konsultim publik për Projektrregulloren për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Prishtinës

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës nuk pati diskutime.

**Kryesuesi** tha se u përkrah **Propozim-vendimi** për vënien në konsultim publik për Projektrregulloren për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Prishtinës dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

**Pika e tretë**

**Diskutim** lidhur me aktivitetin e prokurimit: Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues: 119 programi për ofrimin e shërbimeve të energjisë në ulje të shpenzimeve financiare në Komunën e Prishtinës (SIPA UA 06.2021).

**Leutrim Retkoceri:** - kërkoi të ofrohet material në seancë për pikën e tretë.

**Bahri Gashi:** - tha se kjo pikë duhet të largohet.

**Kryesuesi:** e holli në votim se kush është për të larguar pikën e tretë nga rendi i ditës, **3 janë për, kundër janë 7, abstenime s'ka.**

**Kryesuesi** tha se u përkrah **Diskutimi** lidhur me aktivitetin e prokurimit: Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues: 119 programi për ofrimin e shërbimeve të energjisë në ulje të shpenzimeve financiare në Komunën e Prishtinës ( SIPA UA 06.2021) dhe dërgohet në Kuvend për diskutim.

**Pika e katërt**

**Propozim-vendimi** për subvencionimin e Elza Ujkanit

**Kryetari:** - tha se ka biseduar me familjen Ujkani, kanë propozuar me ndryshuar titullin, jo subvencionim për Elza Ujkanin, por Propozim-vendim për paradhënie lidhur me shpërblimin e dëmit material.

**Arben Kqira:** - tha se për shpërblim të dëmit material duhet pasur një ekspertizë, një vlerësim të dëmit, ndërsa për subvencionim varet sa ka mundësi komuna.

**Kryetari:** - tha e kemi një pro-faturë, prej 78,254.00 euro që e ka dërguar, mirëpo përvèç kësaj ka edhe harxhime të udhëtimit, hotelit etj, kështu që kisha propozuar t'i shtohet edhe një shumë tjetër kësaj shume.

**Arben Kqira:** - propozoi që ky propozim të titullohet Propozim-vendim për kompenzimin e dëmit material dhe jomaterial.

**Kryesuesi** tha se u përkrah **Propozim-vendimi** për subvencionimin e Elza Ujkanit dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

## Pika e pestë

### Informatë lidhur me punën e komisionit të aksionarëve të Ndërmarrjes publike “Prishtina Parking”, SHA

**Gëzim Sveçla:** - pyeti pse kompania “Pastrimi” nuk është paraqitur, ose pse Donat Lushaku është aksionar dhe iu ka dërguar kërkesë për të dorëzuar materialin.

**Kryesuesi** tha se u përkrah **Informata lidhur me punën e komisionit të aksionarëve të ndërmarrjes publike “Prishtina Parking”, SHA** dhe dërgohet në Kuvend për diskutim.

### Të ndryshme

**Gëzim Sveçla:** - pyeti kryetarin për një letër të ardhur nga AKP-ja, lidhur me fshatrat Orlloviç dhe Shkabaj a është i njoftuar.

**Kryetari:** - tha po e kam pranuar dhe jemi në diskutim me prokurorin.

**Gëzim Sveçla:** - shprehu shqetësimin lidhur me ndërtimet në fshatin Shakabj në prona të AKP-së, siç është xhamia, shkolla dhe disa rrugë. Po ashtu tha se AKP i ka dërguar një kërkesë komunës për shpronësim, në të kundërtën do t'i parcializojë dhe do t'i vë në shitje.

**Kryetari:** - tha e kemi marrë kërkesën nga AKP-ja dhe e kemi dërguar në Drejtore të Pronës për shpronësim.

**Gëzim Sveçla:** - një çështje tjetër ka të bëjë me ankesa të shkollave sidomos prej “Xhevdet Dodës”, për rialokim ose zhvendosje të tyre, sepse kjo çështje mundet me u shëndrruar në problematikë.

**Kryetari:** - tha se jemi në diskutim për t'i krijuar 7 ose 8 shkolla tërëditore, jemi duke punuar në riaranzhimin e shkollave nga 1-5 në një shkollë, ndërsa 6-9 në shkollën tjetër.

**Gëzim Sveçla:** - tha se shkolla “Xhevdet Doda” është zhvendosur dy herë. Këtu mund të shkaktohen një varg problemesh tjera, duke filluar nga trafiku e që duhet kaluar edhe një orë rrugë nga zhvendosja e atyre nxënësve.

**Kryetari:** jemi duke e diskutuar këtë, në distancë rreth 300-400 metra, mes të një shkolle në shkollën tjetër dhe pikërisht për këtë që mos me qenë nga 1-9 në një vend, por me qenë nga 1-5 dhe 6-9, mirëpo e gjithë ideja është që të pranohen nxënësit në shkolla të familjeve, të cilat jetojnë aty përreth.

**Bahri Gashi:** - pyeti se si ka ecur propozimi për shujta.

**Arben Kqira:** - tha se po bëjmë një analizë, paraprakisht e kemi bërë edhe vitin e kaluar, është një dispozitë që përsëritet si vitin e kaluar, Ligjin për Ndarje Buxhetore e ndalon pak a shumë.

**Kryesuesi:** - pyeti z.Kqira dhe kryetarin se ligjërisht ai takon ta bartë vulën, pasi zyra nuk është funksionale

dhe prezenca e vulës është e domosdoshme për funksionim të rregullt.

**Arben Kqira:** - tha se keni të drejtë, mirëpo duhet të bëni një kërkesë dhe ta dërgoni në Ministrinë e Punëve të Brendshme, aty është zyrtari përgjegjës i caktuar, i cili vendos për këto vula, p.sh. mua më ka refuzuar për zyrën ligjore.

**Kryesuesi:** - tha se kam një kërkesë për rrugën në Bardhosh, e cila është në shkatërrim, e shtruar para 5-6 muajsh., rruga "Skënderbe" e bllokuar nga krejt nga kanalizimet.

**Milazim Vitija:** - kërkoi të diskutohet çështja e shujtave për punëtorë, në ç'rast tha bashkërisht të gjejmë një mënyrë, ta dërgojmë përpara sepse punëtorët janë në gjendje të keqe.

**Kryetari:** - kërkoi mirëkuptim që subvencionimi i Elzës mos të politizohet dhe mos të jetë temë diskutimi për asnjë arsy, sepse siç tha ai, ata që janë përgjegjës janë duke u hulumtuar, por çështja është delikate dhe prekëse për familjen e Elzës dhe Elzën, andaj i luti të mos lakohet emri i Elzës lidhur me subvencionimin.

*Mbledhja përfundoi në orën 11:50 .*

**Procesmbajtësja  
Shyhrete Islami**

**Kryesues i Komitetit  
Fehmi Kupina**

